

VENDIM
Nr.210, datë 31.3.2010

**PËR KALIMIN E NJË SIPËRFAQEJE, PRONË SHTETËRORE, NË FONDIN E
KOMPENSIMIT FIZIK DHE VËNIEN E SAJ NË DISPOZICION TË AGJENCISË SË
KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 28 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin, e pronës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja prej 27 070 (njëzet e shtatë mijë e shtatëdhjetë) m², me numër pasurie 257/2, zëri kadastral “Shesh”, pronë shtetërore, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kalojë në fondin e kompensimit fizik e të vihet në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi bën verifikimin përfundimtar të pronësisë së truallit, për fondin e mësipërm, e përdor atë për kompensimin e pronarëve, sipas kritereve të përcaktuara në ligj.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

